



Durrës, 25.01.2022

Njoftim për shtyp

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës ndoqi me shqetësim zhvillimet e ditës së hënës në kompaninë “**A.I.B.A. KOMPANI**” dhe biznese të tjera të vëllezërve Agron dhe Armand Duka. Kontrolli i ushtruar në këtë kompani nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve menjëherë pas zhurmës mediatike, që pasoi publikimi nga ana e FSHF-së e një audio përgjimi, ku dëgjohej kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj ndërsa fliste me shprehje të papërshtatshme me anëtarë të Shoqatës së Futbollit Tirana ngjante me një reagim shproporcional dhe të paramenduar. Kontrolli i beftë dhe i komanduar i 15 tatimoreve në Kompanitë e vëllezërve Duka ndikon drejtpërsëdrejti në klimën e të bërit biznes dhe ushtrimin e sipërmarrjes së lirë.

Sot biznesi në Durrës, por edhe më gjërë ndihet i kërcënuar nga presioni që mund të ushtrojë shteti dhe institucionet e tij ndaj subjekteve private.

Reagime të tilla të instancave shtetërore i përngjajnë një presioni publik dhe politik, që kërcënon biznesin e ndershëm për të ushtruar veprimtarinë e tij.

Eksplozivi në derën e shtëpisë së kreut të FSHF-së, por njëkohësisht biznesmenit Armand Duka është një ngjarje shumë e rëndë. Zbardhja sa më parë e saj dhe ndëshkimi i autorit/ve do të përçonte tek sipërmarrja private sinjalin pozitiv se institucionet ligjzbatusse janë në mbrojtje të biznesit.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës i bën apel Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të heqë dorë nga kontrolllet e orkestruara dhe të zbatojë ligjin dhe dispozitat ligjore me përpikmëri, e pandikuar nga askush.